



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 385 Prot.

Tiranë, më 12.01.2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.642, datë 27.08.2001.

**SHOQËRISË “BERALB” SH.A
Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Bisnes Centër, Kati 13, Tiranë**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “BERALB” sh.a, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.642, datë 27.08.2001, për mineralin bakër në objektin “Lak Roshi”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4493, datë 09.12.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8598, Prot, datë 10.12.2020, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.642, datë 27.08.2001, për mineralin bakër, në objektin “Lak Roshi”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, sepse në objekt nuk punohet për më shumë se një vit kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.642, datë 27.08.2001, për mineralin bakër, në objektin “Lak Roshi”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.642, datë 27.08.2001, për mineralin bakër, në objektin “Lak Roshi”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

